



**Dokument i Përmbledhur Shpjegues
për
monitorimin e procesit të konsultimit publik
në nivel qeveritar në Kosovë**

Tetor 2017

Përkrahur nga:



0. Parathënje

Qëllimi i këtij dokumenti shpjegues është që të përshkruajë logjikën prapa metodologjisë e cila është zhvilluar për të monitoruar zbatimin nga organet qeveritare në Kosovë¹ të *Rregullores së Qeverisë mbi Standardet Minimale për procesin e konsultimit publik*², e cila ka hyrë në fuqi me 1 janar të vitit 2017.

Dispozitat e rregullores dhe udhëzuesëve për zbatimin e saj janë “përkthyer” në tregues të monitorimit, të organizuar rreth kategorive vlerësuese. Ideja prapa qasjes së propozuar metodologjike është që të mundësojë monitorimin me kohëzgjatje të madhe dhe që me kohë të ofrojë informata rreth trendeve në vendimmarrjen pjesëmarrëse në Kosovë. Si rrjedhojë, **kategoritë** përfaqësojnë elementin e qëndrueshëm të metodologjisë, ndërkohë **treguesit e veçantë** përbrenda secilës kategori do të mund të përshtaten apo të braktisen me kohë, ndërsa në anën tjetër të shtohen treguesit e rinj përderisa zhvillohen teknologjia dhe praktikatat më të mira, pa penguar logjikën e monitorimit me kohëzgjatje të madhe përgjatë viteve.

Metodologjia përmbanë si treguesit procedural ashtu edhe ata cilësorë, si dhe ndërthurjen e tyre, duke mundësuar si vlerësimin e nivelit të zbatimit të dispozitave procedurale të Rregullores nga organet e ndryshme të Qeverisë ashtu edhe cilësisë së proceseve specifike të konsultimit. Për më tepër, megjithëse shumica e treguesve vlerësojnë nivelin e zbatimit ndaj dispozitave ligjore rreth konsultimit publik, ekziston një numër i treguesve që gjithashtu ofrojnë informata shtesë apo pasqyrojnë praktikatat që tejkalojnë standardet minimale.

Metodologjia është një proces me dy nivele në të cilën përfshihen: **(1) monitorimi i konsultimeve individuale dhe (2) vlerësimi vjetor i proceseve të konsultimit të zhvilluara në nivelin e institucioneve individuale**. Përderisa vlerësimi individual përfshin tërë ciklin e një procesi të konsultimit specifik publik (planifikimi, zbatimi dhe informata kthyes), vlerësimi vjetor i institucioneve individuale zgjerohet edhe me kapacitetet dhe monitorimin e raportimit e brendshëm.

Në mënyrë të veçantë:

1. **Instrumenti për monitorimin e proceseve të konsultimeve individuale** mundëson **monitorimin e vazhdueshëm në nivel të proceseve dhe organeve individuale** dhe shërben për tri qëllime:
 - a. Monitorimin specifik të procesit të konsultimit publik të proceseve të përzgjedhura të politikëbërjes në mënyrë individuale, që nga fazat fillestare deri në vendimin përfundimtar të Qeverisë;
 - b. Bazuar në atë që u përmend më lartë, intervenimet me kohë në proceset që nuk zhvillohen sipas Rregullores, si dhe aktivitete të avokimit dhe aktivitete të ngritjes së vetëdijes së opinionit dhe mediave nga ana e organizatës/organizatave pjesëmarrëse, dhe
 - c. Grumbullimin e të dhënave sistematike për nevoja të vlerësimeve vjetore të organeve përkatëse/njësive qeveritare si dhe qeverisë në përgjithësi.
2. **Instrumenti për vlerësimet vjetore** mundëson **vlerësimin vjetor të performancës së organeve individuale qeveritare në zbatimin dhe monitorimin e brendshëm të proceseve të konsultimit publik**. Në këtë instrument, kategoritë dhe lista e zgjeruar e treguesve mundëson nxerrjen e përfundimeve rreth niveleve të arritjeve të organeve individuale të qëllimeve dhe dispozitave të përgjithshme të Rregullores.

Burimet e të dhënave për monitorimin e metodologjisë përfshijnë Platformën Online për konsultim publik <http://konsultimet.rks-gov.net/>, pjesëmarrjen aktive në takim(e) dhe komunikimin me pjesëmarrësit, analizimin e dokumenteve të konsultimit publik, si dhe pyetësorët dhe/ose intervistat.

¹ Ministrinë dhe Zyrat përkatëse në kuadër të Zyres së Kryeministrit

² Rregullorja Nr. 05/2016

1. Informatat Teknike, trajnimi dhe vëllimi i vlerësuar i punës

1.1 Vlerësimi

Sistemi i vlerësimit mundëson renditjen e organeve individuale qeveritare, ndërkohë që rezultatet e paraqitura në formë të përqindjes së pikëve të përgjithshme maksimale mundësojnë krahasimet e thjeshta ndërmjet tipeve të ndryshme të organeve, si dhe të paraqitjes vizuale të krahasueshme që kuptohen lehtë.

1.2 Formularët e Programit Excel për Futjen e Të Dhënave³

Metodologjia e monitorimit shoqërohet nga dosjet specifike të programit Excel për futjen e të dhënave të cilat duhet të plotësohen nga ana e të gjitha organizatave të përzgjedhura, nën mbikëqyrjen e KCSF-së. Organizatat e përzgjedhura do të fusin të dhënat vetëm për proceset specifike të cilat ata i monitorojnë. Udhëzimet e hollësishme do të ofrohen nga KCSF në trajnimin fillestar për organizatat e përzgjedhura, si dhe në formë të shkruar dhe përmes mentorimit të vazhdueshëm.

1.3 Pyetësorët për organe qeveritare

Instrumentet shpesh të metodologjisë së monitorimit janë pyetësorët për organet qeveritare të cilët rradhisin të gjitha informatat e domosdoshme që organet do të duhej të ofronin për të mundësuar vlerësimet vjetore. Informacioni i kërkuar në këta pyetësorë do t'u mundësojë organizatave monitoruese që t'u përgjigjen treguesve që nuk mund të plotësohen përmes procesit individual të monitorimit. Pyetjet kanë të bëjnë me kapacitetet e tyre të brendshme dhe detyrat e monitorimit në bazë të Rregullores, si dhe proceset e tyre të brendshme që lidhen me organizimin e konsultimeve. Disa pyetje kërkojnë dëshmi (theksimi i datës, bashkangjitja e një kopjeje të dokumentit, specifikimi i vendit dhe datës së takimit, etj.). Parashikohet që pyetësorët të dërgohen në periudhën kur përgatiten raportet vjetore të organeve qeveritare, për shkak se ato tashmë do të jenë të njoftuara me temën (në fund të janarit). Si alternativë tjetër do të ishte kryerja e intervistave gjysëm të strukturuar me përfaqësuesit e organeve qeveritare të cilët kanë qenë të përfshirë në planifikim dhe zbatim të konsultimeve, duke siguruar kështu që të gjithë pyetjet e pyetësorit janë përfshirë. Nëse nuk i përgjigjen pyetësorëve apo refuzojnë që të intervistohen, të gjithë treguesit burimi i informacionit i të cilëve është pyetësori marrin 0 pikë, edhe nëse për disa prej tyre e dini se në të vërtetë i kanë plotësuar.

KCSF synon që të nënshkruajë një Marrëveshje Bashkëpunimi (MB) me Qeverinë për lehtësimin e procesit të monitorimit, duke përfshirë përkushtimin për t'u përgjigjur pyetësorëve apo kërkesave për intervista. MB-të specifike, bazuar në MB-në e përgjithshme, do të merren parasysh nëse është e domosdoshme.

1.4 Trajnimi dhe Mentorimi i KCSF'së

KCSF do të organizojë një trajnim fillestar dyditor, duke u përqendruar si në standardet minimale për konsultim publik (dita e parë) ashtu edhe në metodologjinë e monitorimit (dita e dytë). Trajnimi është i detyrueshëm për të gjitha organizatat e përzgjedhura dhe stafin i cili do të përfshihet në monitorim. Nëse ka nevojë për më shumë trajnime, KCSF do t'i koordinojë ato me organizatat e përzgjedhura rreth detajeve të mëtutjeshme. Për më tepër, KCSF do të jetë në dispozicion për ndihmë të vazhdueshme dhe mentorim, kryesisht rreth zbatimit të metodologjisë së monitorimit, por gjithashtu edhe për përmbajtjen e proceseve të konsultimit publik. Vlerësohet se një mentorim i tillë do të jetë më intensiv në muajt e parë të praktikës së monitorimit se sa më vonë gjatë vitit.

³ Dosjet Excel janë opsione rezervë që mundësojnë monitorimin e proceseve derisa të zhvillohet një databazë e bazuar në web. Databaza do të duhej të përmbante të gjitha informatat e specifikuar në udhëzues dhe në formularët për futjen e të dhënave; fushat e "vlefshmërisë së të dhënave" duhet të mundësojnë futjen e lirë të tekstit, në mënyrë që hulumtuesit të mund të fusin informacionin e kërkuar për vlefshmëri.

1.5 Vëllimi i vlerësuar i punës

Për shkak të dinamikave të ndryshme të proceseve specifike të politikëbërjes, angazhimi i organizatave të monitorimit nuk do të jetë i njëjtë përgjatë gjithë kohëzgjatjes së procesit. Përkundrazi, mund të ketë periudha të angazhimit më intensiv, sikurse periudhat tjera pa zhvillime/monitorim. Për këtë arsye vëllimi i vlerësuar i punës llogaritet në bazë të monitorimit të një procesi të politikëbërjes, e jo në baza mujore. Përlllogaritjet përfshijnë të gjitha fazat nga takimet fillestare të konsultimit deri në dorëzimin e tyre tek Qeveria për miratim. Duke ditur që secili proces i politikëbërjes mund të ketë zhvillime specifike, kjo përlllogaritje merr parasysh procedurat standarde dhe praktikatat e zakonshme të proceseve të politikëbërjes dhe konsultimit publik.

Aktivitetet kryesore që do të zhvillohen gjatë monitorimit të një procesi të politikëbërjes janë:

1. Monitorimi i takimeve publike
2. Monitorimi i konsultimeve në formë të shkruar
 - a. Analiza e përmbajtjes së Dokumentit të Konsultimit
 - b. Analiza e Raportit Përfundimtar të Konsultimeve (duke përfshirë informatat kthyes)
3. Zbatimi i pyetësorit/anketës
4. Intervistat gjysëm të strukturuar
5. Futja e të dhënave në formularët e monitorimit
6. Raportimi i rregullt i rezultateve të monitorimit te KCSF

Përveç kësaj, aktivitetet e mëposhtme parashikohen që të zhvillohen vetëm njëherë gjatë vitit:

1. Dorëzimi i listës përfundimtare të dokumenteve të cilat do të monitorohen, pas miratimit të Planit Vjetor të Qeverisë⁴
2. Pjesëmarrja në trajnimin fillestar të organizuar nga KCSF
3. Konsultimet e rregullta me KCSF-në rreth metodologjisë së monitorimit dhe zhvillimeve specifike

Shumica e këtyre aktiviteteve të përmendura më lartë kërkojnë angazhimin e stafit me aftësi solide të hulumtimit dhe përvojë në politikë-bërje, si dhe trajnim të përfunduar të metodologjisë së monitorimit dhe procesit të konsultimit publik të organizuar nga KCSF. Ky angazhim ka të bëjë kryesisht me punën në zyrë (analizimi i Platformës Online dhe materialeve të konsultimit), ndërsa pjesa tjetër është pjesëmarrja direkte në një apo disa takime publike, komunikimi me pjesëmarrësit dhe institucionet publike dhe zbatimi i numrit të kufizuar të pyetësorëve dhe/ose intervistave gjysëm të strukturuar. Kërkohej gjithashtu edhe angazhimi në lidhje me analizën e Planit Vjetor të Punës për ministritë e përzgjedhura para dorëzimit të listës përfundimtare të dokumenteve që do të monitorohen, analizën e përmbajtjes së Dokumentit të Konsultimit dhe analizën e përmbajtjes së Raportit Përfundimtar të Konsultimit (duke përfshirë cilësinë e informatave kthyes).

Meqenëse organizatat e përzgjedhura pritet që të jenë të specializuara në fushat që do të monitorohen, supozohet se dokumentet specifike që do të monitorohen janë me interes për organizatën pavarësisht financimit të KCSF'së. Si rrjedhojë e kësaj, përveç fondeve të siguruara nga ana e KCSF'së, secila organizatë përgjegjëse për monitorim pritet që të ketë një nivel të caktuar të kontributit gjatë fazës së konsultimit publik.

⁴ Për qëllimin e këtij monitorimi, pjesët përkatëse të Planit Vjetor të Qeverisë janë: Programi Legjislativ; Lista e Koncept-Dokumente; Programi Vjetor i Dokumenteve Strategjike